



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 151/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në rrethojë të ndërtesës publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

Subjekti politik PDK, me datën 03.10.2013, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 3 Tetor 2013, subjekti politik i LDK-së, ka vendosur posterin e kandidatëve për kuvendin e komunës, në objektin- rrethojën e OJQ “ Hendifer”, si dhe rrethojës së Çerdhes së fëmijëve “ Ardhmëria “me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Rregullës Nr.01/2012, si dhe neni 4 pika b, i Rregullës zgjedhore nr.11/2013, Kodi i Mirësjelljes për subjektet politik, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Parashtruesi i ankesës kërkon që të shqiptohen masa ligjore për këtë shkelje.

Ankesës i ka bashkangjitur si provë fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 04.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.10.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik, në të cilën theksohet se ankesa e ushtruar ndaj subjektit politik LDK është e pabazuar nga fakti se fotoja e ofruar si provë nuk e qartëson objektin në të cilin është vendosur, por në këtë rrethojë shihet një firmë e një OJQ-je, e cila nuk tregon se rrethoja është e një objekti publik, thuhet në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik PDK, pretendohet se subjekti politik i LDK-së, ka vendosur posterin e kandidatëve për kuvend të Komunës, në objektin- rrethojën e OJQ “ Handifer”, si dhe rrethojës së çerdhes së fëmijëve “ Ardhmëria”, PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është dëshmi me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografia e ofruar si provë nga subjekti politik i PDK-së, shihet se në rrethojën në të cilën gjendet posterin i lartpërmendur, nuk shihet asnjë objekt i cili identifikohet se aty ekziston çerdhja e fëmijëve “ Ardhmëria”, siç pretendohet, ndërsa në rrethojën e cila pretendohet të jetë e OJQ-së “Handifer”, nuk shihet asnjë poster i vendosur siç thuhet në ankesë. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, neni 3.6 pika b), dhe në kuptim të nenit 115.1, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 151/2013 më datën 05.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*